

REPUBLIKA E KOSOVËS
ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KOMISIONI I ANKESAVE

Nr. prot. 01/2025

Data: 02.05.2025

Prishtinë

VENDIM

Në mbështetje të nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 19 të Ligjit Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenit 26 të Statutit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për periudhën e përkohshme, si dhe nenit 10 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Komisioni i Ankesave i OIRK-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.04.2025, në përbërje: Kryetar: Petrit Hajrizi dhe anëtarë: Bekim Ahmeti dhe Ekrem Sallahaj, pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur, nxjerr këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga znj. **Betime Baftiu Jetullahu**, e datës 02.04.2025, dhe precizimi i saj i datës 17.04.2025.

Në fuqi mbetet Raporti i Përzgjedhjes së Kandidatëve për pozitën Drejtor Ekzekutiv i OIRK-së, i hartuar nga Komisioni Vlerësues më datë 01.04.2025.

ARSYETIM

Komisioni i Ankesave shqyrtoi ankesën e znj. Betime Baftiu Jetullahu, e cila pretendon shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të disa akteve ligjore dhe nënligjore, përfshirë: Ligjin e Punës Nr. 03/L-212; Ligjin Nr. 06/L-144 për Zyrtarët Publikë; Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi; Udhëzimin Administrativ MFPT-NR. 01/2024

Pas shqyrtimit të pretendimeve dhe dokumentacionit përkatës, Komisioni konstaton se:

Oda e Inxhinierëve dhe organet e saj funksionojnë mbi bazën e Ligjit Nr. 08/L-012 dhe Statutit të saj, dhe nuk janë subjekt i zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Marrëdhëniet e punës rregullohen nga Ligji i Punës Nr. 03/L-212 dhe aktet përkatëse të brendshme të OIRK-së.

Procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor Ekzekutiv është zhvilluar në përputhje të plotë me UA MFPT-NR. 01/2024 dhe aktet e brendshme të OIRK-së.

Znj. Jetullahu ka qenë pjesë e procesit të vlerësimit në mënyrë të barabartë me kandidatët e tjerë dhe është ftuar për intervistë më 21.03.2025.

Intervista dhe vlerësimi janë realizuar nga një komision me pesë anëtarë, duke përdorur formularë të standardizuar të vlerësimit, të miratuar paraprakisht nga Bordi Drejtues.

Sipas rezultateve përfundimtare të intervistës së datës 01.04.2025, znj. Jetullahu është renditur në vendin e dytë me me 84.63 pikë.


Komisioni nuk ka konstatuar elemente të diskriminimit apo shkelje të parimeve të barazisë dhe transparencës gjatë procesit të rekrutimit. Procedura ka qenë e hapur, transparente dhe është zhvilluar në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në mungesë të provave që dëshmojnë shkelje të rënda procedurale apo ligjore, Komisioni vlerëson se ankesa është e pabazuar në fakte apo në ligj.

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë padi pranë gjykatës kompetente brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Për Komisionin e Ankesave të OIRK-së
Prishtinë, më 02.05.2025



Petrit Hajrizi
Kryetar i Komisionit të Ankesave



Bekim Ahmeti
Anëtar i Komisionit të Ankesave



Ekrem Sallahaj
Anëtar i Komisionit të Ankesave